



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 16    Datë 10.04.2017

**“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE”- SUBJEKTIT “CR POWER 2016” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 4219/7, datë 28.07.2016 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujor të subjektit “**CR POWER 2016” SH.P.K** me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**V e n d o s i :**

1- Miratimin e kërkesës së subjektit “**CR POWER 2016” sh.p.k** me administrator Z.Avenir ALLUSHI , për përdorim të burimit ujor **Përroi i Thatë**, degë e Lumit Zalli i Bulqizës , për prodhim energjie elektrike në Fushë- Bulqizë,Njësia Administrative Fushë-Bulqizë ,Bashkia Bulqizë , Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti , objekti HEC TEZALLE 1 do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes :        X – 44 39 833 ;    Y – 45 93 766 ;    Z – + 1542 m  
Koordinatat e godinës së centralit:    X – 44 40 302;    Y – 45 97 104 ;    Z – + 840.89 m  
Koordinatat e pikes së shkarkimit :    X – 44 40 302;    Y – 45 97 104 ;    Z – + 840.89 m  
Prurja mesatare e përroit:  $Q_{mes} = 0.136 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;  
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:  $Q_{llog} = 0.25 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;  
Prurja ekologjike:         $Q_{ekol} = 0.027 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;  
Prurja që shkarkohet:     $Q = 0.25 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

2- Leja e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETARI**  
**Martin PLLUMBI**



**KRYETARI**  
**Paulin RADOVANI**